

At Pano Gjezo

Shën Mëria Arbëreshe



U botua ky libër me ndimën ekonomike
të z. Athanasios Martinos

Falënderime

Falënderoj përzemërsisht mësuesit e filologjisë shqipe Kristo Guma dhe Elez Pepohisi dhe zonjën Eva Mëhilli, z. Konstantin I. Çopani, dr. në degën e historisë dhe filosofisë të feve dhe shkrimtar, mësuesin e filologjisë greke Stiliano Kutri, mësuesit e filologjisë greke dhe shkrimtarë: Theleksinoi Kondoiani dhe Stergio Vankli, shkrimtarin Aristoteli Papa, ushtarakun Panajoti Kapeloni për ndihmën e madhe që më dhanë për të bërë këtë studim.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

- 1 Prolog f. 4
2. HYRJE f. 6
3. Historia e SHën Mërisë Arbëreshe. f. 8
4. Historia e arbëreshëve.f.10
5. Gjuha arbëreshe.f.20
6. Disa figura të shquara arbëreshe. f.60
7. Krijime popullore nga folklori arbëresh. f.100
8. Mendime të lexuesve 121
9. Bibliografia. f. 124

Prolog

Pesë vjet më parë, kur isha kryetar bashkie në qytetin Keratea, kisha nderin të shkruaja prologun e fjalorit, të parë dhe të vetëm në historinë e shtetit grek, të gjuhës arbëreshe «Αρβα-νίτικο Λεξικό», (Fjalori Arbëresh), vepër e bashkpatriotit tim z. K. Çopani. Siç dihet, në Keratea dhe në shumë krahina të tjera të Athinës si dhe në krahina të tjera të Greqisë banorët janë me origjinë arbëreshe. Gjuhën tonë arbëreshe e folën stergjyshërit dhe prindërit tanë deri në ditët e sotme, është gjuha jonë që fatkeqsisht ka filluar të harrohet nga fëmijët tanë. Është kjo arsyeja që u gëzua pa masë kur u botua fjalori i sipërpërmendur. E ndjej si detyrë edhe unë me arbereshët e tjerë të ndihmojmë sadopak që të mos zhduket gjuha, historia dhe zakonet e të parëve tanë, të cilat deri tani i kalonim gojë më gojë pa i shkruar.

Sot jam shumë i kënaqur që kam në dorë librin “Shën Mëria Arbëreshe”, shkruar nga at Pano Gjezo, prifti nga Himara dhe mësues i gjuhës shqipe. Është një vepër që ndihmon në plotsimin e boshllëkut të historisë të Arbëreshëve të Greqisë.

Kam lexuar mjaft studime për historinë dhe gjuhën e Arbëreshëve të Greqisë të botuara si në Greqi dhe në vende të tjera të Ballkanit... Nga libri “Shën Mëria Arbëreshe” mësova me gëzim se në ishullin Hio ka një kishë ortodokse, që emërohet “Shën Mëria Arbëreshe”. Ne arbëreshët, Μεσογείτες, e krahinave të periferisë Mesoja në Athinë, i kemi dhënë Shën Mërisë, tek e cila shpresojmë dhe i lutemi shpesh, emra të veçanta si «Σσερ Μεριε ντέρα ε ντέτιτ» “Shën Mëria e përtej detit”. Kështu quajmë Shën Mërinë e Tinos. Në fshatin Kuvara i dhamë emrin «Σσερ Μεριε ε Λεχούβε», “Shën Mëria e Lehuve”, “Shën Mëria e vrahevet” (vrahevet – e shkëmbenjve, shënimi im) «Σσερ Μερίε ε Βράχεβετ».

Në qindra emra, me të cilat e njohim Shën Mërinë, në mendjen time shtohet dhe ai i Shën Mërisë Arbëreshe. At Pano Gjezo na tre-

gon në faqet e para të këtij libri me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme besimin e madh që kanë arbëreshët tek Shën Maria për të lehtësuar shpirtin e tyre në situata të vështira si dhe në shërimin e sëmundjeve fizike dhe shpirtore të tyre.

«Ουράτεν ζότ πρίφτη! Τέ γιεσς ι μπεκούαρ!» (Paç uratën e Zotit, o prift për këto që na shkruan! Qofsh i bekuar!)

Në këtë libër na jepen të dhëna të vlefshme dhe interesante edhe për historinë dhe gjuhën e arbëreshëve si dhe për folklorin e tyre. Po ashtu vë në dukje dhe mjaft figura të shquara me origjinë arbëreshe që u dalluan në luftën e popullit grek për liri, në politikë, në shkencat dhe në kulturë. Kemi pak libra të tilla, në të cilat njihemi me jetën dhe historinë e arbëreshëve të marra nga goja e të gjithë atyre që kanë origjinë arbëreshe. Edhe ky libër, që na dha sot at Pano Gjezo-ja është një burim i bollshëm për brezat e ardhshme të pasardhësve tanë arbëreshë që të krenohen për historinë e stërgjyshëve të tyre, të cilën do t'ua mësojmë dhe gjithë atyreve që shkruajnë sot Historinë e Botës. Për këtë arsye këtë libër e rekomandojmë tek gjithë ata që kërkojnë të mësojnë të vërtetën për arbëreshët.

Stavro Jatru

Kryetar Bashkie i Kerateas

Përkthimi i prologut të mësipërm nga autori i këtij libri, at P. Gjezo.

HYRJE

I Madhi Zot, Perëndia Triun (I Ati, i Biri dhe Shpirti i Shënjtë) krijoi Gjithësinë e përkryer. Gjithësia është një mrekulli e pabesueshme, e çuditshme. Mrekulli të tilla kanë ndodhur dhe vazhdojnë të ndodhin me shumicë në shekuj para syve të njeriut, sepse vetëm kështu mundet të mirëmbahet dhe të rigjenerohet gjithë universi. Njeriu u krijua me logjikë dhe është e vetmja krijesë e ngajshme me krijuesin saj, që sundon në gjithë botën. Një nga çudirat e të Madhit Zot është dhe shën Mëria. Para se të lind u shënjtërua nga Zoti dhe, që në moshë akoma të re, lindi birin e Zotit, Jezu Krishtin, natyrën njerëzore të Perëndisë dhe u bë Virgjëresha, kryeshënjtoria (Panagia). Virgjëresha është mëma e natyrës njerëzore të Perëndisë, po ashtu është mëma e gjithë njerëzve. Ajo është Kryeshënjtoria e grekëve, e arbëreshëve dhe e të gjithë njerëzve, e cila na konsideron si fëmijët e saj, na fal gabimet tona, dëgjon kërkesat tona dhe lutet Zotit të na hapë sytë dhe veshët si dhe të na japë durim që të përballojmë me besim të gjithë vështirësitë e jetës.

"A dëgjoni? "Arvanite" më thërrasin. Shpirti i Shenjtë i mësoi të më thërrasin kështu. E pranova këtë emër që më dhanë me shumë kënaqësi".

Historia e Shën Mërisë Arbëreshe



«Kishëza që ndodhet në Karje të ishullit Hio i kushtohet Shën Mërisë Arvanitase. Perandori Kostantinos Monomahos IX (1042 – 1054 pas Kr.) dërgoi në ishullin Hio ustallarë të veçantë nga Vorio Epiri, që ishin të specializuar për gdhendjen e gurit të ndërtonin në Karie të Hios një manastir të ri. Pasi endërtuan manastirin (i cili me gjithë plaçkitjet dhe shkatërrimet që iu bënë nga pushtuesit turq, vazhdon të funksionojë sot e kësaj dite), gjithë ata ustallarë u ngulën në atë ishull të Hios si

banorë të përhershëm. Pasardhësit e tyre u bënë çobenj dhe u vendosën në “Kohlia”, që përfshin fshatrat Karjes, Avgonima, Anavato dhe Dhafnona. Çobenjtë që banonin në atë vend e që sot quhet “Shën Mëria Arvanitase” shihnin herë pas here një vajzë shtathedhur me kostum arbëresh që ecte si sorkadhe në kodra e në brinja. Shumë shpejt e njohën. Ishte Shën Mëria. Për arsye se ishte veshur me kostum arbëresh, i dhanë emrin Shën Mëria Arvanitase».¹

Shën Mërisë populli i ka ngjitur rreth 500 emra. Profesori i The-

¹ uers.sch.gr/aiasgr/Theotokos.../Istorikes.../Panagia_h_Arbanitissa.htm (përktheu në shqip at P. Gjezo)

ologjisë A. Kariotoglu na thotë: “Emrat e ndryshme që ka Shën Mëria kanë të bëjnë me vendin dhe mënyrën e shenjtografisë dhe vazhdon më poshtë si dhe me mënyrën e mbajtjes të foshnjës së saj, J. Krishtin”. Disa nga kishat më të dëgjura me emrin e Shën Mërisë emrin plotësues e morën nga pozicioni gjeografik ku ishin ndërtuar. Emri Shën Mëria Arvanitase ishte një nder i madh për arvanitasit sepse ishte një emër që nderonte një popullsi të madhe, gjithë Arbëreshët. Asnjë emër tjetër nga 500 emrat që ka Shën Mëria nuk shpreh një kuptim kaq të gjerë. Si rrjedhojë kemi një masë tepër të madhe besimtarësh ortodoksë –arvanitas, që thërresin me zë të lartë: Shën Mëria është Arvaniteee!

Dhe Shën Mëria u drejtohet grekëve:

" A dëgjoni? “Arvanite” më thërrasin. Shpirti i Shenjtë i mësoi të më thërrasin kështu. E pranova këtë emër që më dhanë me shumë kënaqësi. Vendosa të ikij nga majat e kodrave të “Kohlia”- s, që të shkoj gjithandej ku janë grekë, të qëndroj midis tyre. Dua të më njohin gjithë grekët me emrin Arvanite. Ta mësojë gjithë Greqia këtë emër “Shën Mëria Arvanite”, siç më thërrasin arvanitasit. Mos ta harroni kurrë këtë emër. Vëllezërit tuaj arvanitas - grekë të mos i përbuzni, as t' i shani, përkundrazi t' i mbani gjithëmonë brenda në zemrën dhe në shpirtin tuaj, sepse ata ju kanë mbrojtur nga çdo rrezik që u kërcënonte herë pas here. Për grekët e Moresë, të Makedonisë, të Epirit, të Rumelisë dhe për grekët që banojnë në të gjithë ishujt e Greqisë, ata trima që quhen Greko-Arvanitas, kanë derdhur gjakun e tyre lumë në sulmet luftarake të armiqve të ndryshëm për të mbrojtur Atdheun e përbashkët”².

"Shën Mëria Gjurmëza" është monastiri në Paramithja. Thuhet dhe besohet deri sot se në atë vend u gjet dikur një ikonë e shën Mërisë. U gjetën po ashtu dhe gjurmë të dukshme të këmbëve të saj në ato vende ku shkelte dhe ecte³.

²ënjte 22 Janar 2015 21.35 nga "enromiosini. gr

³(Nga libri i Thanasit Moraitit: "Antologjia e këngëve arbëreshe të Greqisë". Athina 2002, faqe 33, libër që e nënvizon F. M. Athanasios në librin e tij "Gramatika e gjuhës arbëreshe" f. 38.(përkthyer në shqip nga at P. Gjezo)

«ΣερΜερικεντέραντέτιτ»“Shën Mëria e përtej detit”. Kështu quajmë Shën Mërinë e Tinos. Në fshatin Kuvara i dhamë emrin «ΣερΜερικεΛεχούβε», “Shën Mëria e Lehuve” , “Shën Mëria e vrahevet” (vrahevet – e shkëmbenjve , shënimi im) «ΣερΜερικεΒράχεβετ». (nga prologu i këtij libri).

Monastiri i shën Mërisë "Ομπλού" (ëmbël) në rrethin Ahaias Patra është monastir i arvanitasve dhe quhet "Shën Mëria e ëmbël"....

HISTORIA e ARBËRESHËVE GREKË - ARVANITAS

"Duam s' duam jemi popuj vëllezër me të njëjtën histori, me të njëjtën origjinë dhe me zakone të njëjta":

*Janis Kumaris
(Fjalori enciklopedik " ΗΛΙΟΣ".)*



Dihet mirë nga të gjithë për lëvizjet e popullatës që kanë ndodhur në shekuj nga një vend në një tjetër për arsye të ndryshme ekonomike, shoqërore, politike... Vendi që boshatisej zakonisht plotësohej nga banorë të rinj. Po japim një shembull: Kaonët, një fis i Epirit, në vitin 170 p. K., kur erdhën pushtuesit romakë në vendin e tyre, u larguan pjesa më e madhe dhe u vendosën

në veri të Sirisë. Aty formuan Kaoninë e Re, banorët e të cilës jetojnë deri sot aty, në Siri.

“Në shekujt 14-15 një masë e madhe arbëreshësh u larguan nga vendi i tyre, nga Ballkani Perëndimor dhe u vendosën në Greqinë Jugore. Arsyet e mërgimit të kësaj popullsie qenë shkaqet ekonomiko- shoqërore si dhe interesat e politikës pushtuese të Firencës në Athinë, de Vilanova, të Venedikasve në Evia, të Frankëve në Peloponez...të cilët ndihmonin në masë të madhe mërgimin e arbëreshëve në zonat e sipërpërmendura për t’ i kolonizuar më lehtë ato vende. Në vitin 1830 mbretëria e Greqisë u dha shtetësinë greke gjithë arbëreshëve, një shumicë e madhe banorësh, që ishin vendosur deri në atë kohë në të gjitha krahinat e Greqisë. Arbëreshët në Greqi banonin kryesisht në pjesën juglindore të saj: Viotia, Lokridha - në të gjithë rrethinën e Athinës, veç krahinës Megara, në ishujt e Argosaronikut, veç ishullit Egjina, në pjesën jugore të Evias (Karistia, Kavondoro, (veç krahinën Karistu) dhe pjesën veriore të ishullit Andro, një zonë e madhe në Argolidhokorinthia, Ahaia (Panahaiko me krahinën Araksu) Trifilia (Sulimohorja) dhe në bregdetin Lakonia (krahina Zaraka, e cila është dhe një vazhdim jotokësor nga ishulli Speca i Argolikës)⁴.

Në shekujt 14 --15një masë e madhe arvanitasish erdhën në pjesën më jugore të Peloponezit (në Greqi) në Argolidhokorinthia, Lakonia, Ahaia, Arkadia dhe Mesinia- Ilija- Gortinia.⁵

Për herë të parë bëhet fjalë për arvanitasit në Athinë në ekspeditën e Athinës, siç na shkruan konsulli i Anglisë Zhan Xhiro, për nder të ambasadorit të Francës markez de Nuardel, në vitin 1674 ⁶.

⁴ “Arbëreshët dhe këngët e tyre në Greqi- të Leonidha Empirikut, historian dhe të Thanasit Moraitit” Nga libri i Thanas Moraitit “Antologjia e këngëve të arbëreshëve të Greqisë v.2002 f. 14- Ανθολογία αρβανίτικων τραγουδιών της Ελλάδας σ..14).«Οι Αρβανίτες και τα τραγούδια τους στον Ελλαδικό χώρο – των Λεωνίδα Εμπειρικού, ιστορικού και Θανάση Μωραΐτη». Από το Ανθολογία αρβανίτικων τραγουδιών της Ελλάδας σ..14

⁵ Arbëreshët dhe këngët e tyre në Greqi. 28 - Avθ...σελ.28

⁶ M. Maxime Collignon, Le consul Jean Giraud et sa relation de l' Attique a XVIIe siecle. Extrait des Memoires de l' Academie des Inscription et Belles- Lettres, tome XXXIX, Paris 1913, f.37{395} dhe 38 (406).

Z. Xhiro, për arvanitasit në Athinë dhe në periferinë e saj, shkruan si më poshtë: "Qyteti (Athina) ndodhet poshtë kalasë së lartë. Turqit zotërojnë pjesën më të madhe të arave, një pjesë të vreshtave dhe të ullinjve, grekët kanë pjesën më të madhe të ullinjve dhe të vreshtave dhe pak ara, kurse arvanitasit, të cilët para rreth 30 vjetsh zotëronin arat në të gjitha fshatrat rreth Athinës, kanë 1/3 dhe 2/3 e pasurisë së tyre e kanë marrë turqit dhe arvanitasit u nënshtruan prej këtyre të fundit dhe punojnë si shërbetorë në ish tokat e tyre"⁷.

"Në regjistrimin e popullsisë së krahinës së Thiva - s (Greqi) të 1/1/1936 u gjetën 52991 banorë me origjinë shqipfolëse në qytetin e Thivës dhe në 40 fshatrat e krahinës së saj. Nga ata thuajse të gjithë janë shqipfolës. Në shumicën e tyre flitet në gjirin familjar dhe greqishtja. Vetëm në pak fshatra (në ato, Dervenohorja- ταΔερβενοχώρια) ekzistojnë disa, sidomos gra të moshuara, që nuk dinë greqisht. Gjithë ata janë pasardhësit e arbëreshve që banojnë në gjithë krahinën e Viotisë (Βοιωτία) në mesin e shekullit 14të⁸.

Salamina (ishull i Greqisë) u kolonizua nga arvanitasit fillimisht në vitin 1394 dhe sërish në shekullin 15të. Dialekti i atyre arvanitasve është i ngjajshëm me atë të Atikisë me ngjashmëri leksikofonetike dhe me të folurit e arvanitasve që ndodheshin nga veri-perëndimi i Salaminës (Kryekuqi ose Erithrea, Vilja, Mazi, Mandra, Magula. Aspropirgos, Liosja, Menidhi, Kukuvaunes,

⁷ nga libri i K. Birit "Arvanitasit e Greqisë së Re", Athinë 1960 f. 221-224 - një pjesë e këtij libri "Arvanitasit e parë në Viotia, Lokridha dhe Atiki" ("Arbëreshët dhe këngët e tyre në Greqi f. 28 - Avθ...σ.28) – "Οι πρώτοι Αρβανίτες στη Βοιωτία, Λοκρίδα και Αττική Κώστα Μπίρη - απόσπασμα από το βιβλίο "Αρβανίτες του Νεώτερου Ελληνισμού, Αθήνα 1960, σσ. 221-224 Από το Ανθολογία αρβανίτικων τραγουδιών της Ελλάδας σ..20

⁸ Nga studimi që kanë bërë studiuesit e Bankës Bujqësore të Greqisë (n. 5 të arshivës bujqësor- ekonomike 1939) - ("Arbëreshët dhe këngët e tyre në Greqi f. 28 - Avθ...Φ 23) - Από μελέτη της Αγροτικής Τράπεζας της Ελλάδας (αρ. 5 του αρχείου γεωργό-οικονομικών μελετών της), που έκαναν οι Δ. Σ. και Ν. Η. Αναγνωστόπουλος και δημοσιεύτηκε το 1939. σ. 23 Ανθολογία.....

Qurka, Kakosalesi ose Avlona, Kapandriti, Marathonas) si dhe me ata të juglindjes së saj (Liopeshi ose Peania, Shpata, Koropi, Markopulo, Kalivja, Kuvara, Keratea).

Ardhja e arvanitasve në Salaminë –nga Taso P. Karanti Καραντή, aspirant fakultetit të Teologjisë në Universitetin e Athinës dhe aspirant i Kendrës Studimore të Evropës Juglindore – Arkivi i Studimeve Arbëreshe, botim i Thamiris, Athinë 1996 vëllim i Parë f. 53). Marr nga libri “Arbëreshët dhe këngët e tyre në Greqi” f. 24.⁹

Vendosja e arvanitasve në Evia (Εύβοια- Greqi) fillon pas vitit 1402,.. Zona gjeografike e Evias, ku flitet arbërisht është Karistia, dhe fillon nga jugu i Avlonariut dhe Aliveriut (ΑυλωναρίουκαιτουΑλιβερίου) dhe arrin më në jug në Karisto e në Marmari (ΚάρυστοκαιστοΜαρμάρι). Janë 60 fshatra, ku flitet arbërishtja.Marr nga libri “Arbëreshët dhe këngët e tyre në Greqi”f. 27. (Ανθολ. σ. 27).

"Grekët në atë kohë kishin nevojë për burra, sepse nga luftërat e vazhdueshme vriteshin shumë prej tyre dhe ishte vështirë të përballonin sulmet e gjithë atyre armiqve, po ashtu të kultivonin arat që të siguronin problemin ushqimor. Kështu emri “Bura” (është fjala shqipe “burra”) është fjalë arvanite, që ka të bëjë me një kaçak të dëgjuar të krahinës Arkadia i quajtur Petro Bua i çalë, i cili quhet dhe Petro Burra, një nga arvanitasit e parë që erdhën në Peloponez në vitin 1348, të cilin bashkë me shumë arvanitas të tjerë i mobilizoi Despoti i Mistras Manuil Kantakuzino të mbrojnë kufitë dhe fshatarët e asaj krahine". (f. 30 e librit të Dionisit Karajani “Manastiri Shën Mërisë Bura Megalopoleos, Botimi i tretë), kurse në faqen 46 të atij libri: “Është periudha kur në Peloponez kishte rënë një sëmundje ngjitëse dhe e pashërueshme që korri një shumicë të madhe njerëzish dhe detyroi Despotin Manuil të sjellë shumë familje arvanitase për të plotësuar nevojat e fshatit për fuqinë punëtore dhe mbrojtëse".

⁹ Η παρουσία των αρβανιτών στη Σαλαμίνα του Τάσου Π. Καραντή, πτυχιούχου Θεολογικής Σχολής του Πανεπιστημίου Αθηνών και πτυχιούχου του Κέντρου Σπουδών Νοτιοανατολικής Ευρώπης. (Αρχείο Αρβανίτικων Μελετών, εκδ. Θάμυρις, Αθήνα 1996μ τομ. Α' σ. 53). Από το Ανθολογία αρβανίτικων τραγουδιών της Ελλάδας σ..24

Arvanitët bënë shërbimin ushtarak në ushtrinë Bizantine dhe Dinastia e Paleologëve i përdorte shpesh në shumë beteja ushtarake. Në një rast dërguan 6000 Arvanitë nga Glarenxa (Kyllini - Peloponisi) në fushën e betejës.

Gjithashtu dhe Venecianët rekrutuan shumë ushtarë me rrogë nga Arvanitasit të quajtur Stradioti. Francezi Filip dë Cominës (1447-1511) me sa pa me sytë e tij na dëshmon se në zonën ushtarake të Nafplios Venecianët kishin ushtarë arvanitas si këmbësorë ashtu dhe kalorës.

Në shekullin e pesëmbëdhjetë, pas vdekjes të heroit kombtar Gjergj Kastriotit, Skënderbeut¹⁰ si dhe sundimit të Arbërisë nga Perandoria Otomane, kemi një lëvizjetë re të madhe të popullsisë arbëreshe në Jug të Ballkanit në Greqi. Aty i thërrisnin "Arvanitë". Shkaqet e këtij mërgimi të arbëreshve ishin shoqërore dhe politike. Mërgimi për ata ishte e vetmja rrugë që të shpëtonin nga feudalët arbëreshë, të cilët u merrnin me forcë tokat e tyre. Një tjetër arsye ishte pushtimi otoman. Kurbeti i arbëreshëve ishte një formë kundërshtimi ndaj shtypjes shoqërore që ushtronin feudalët arbëresh dhe turq ndaj tyre, e cila u bë e padurueshme.



¹⁰ Gjergj Kastrioti, Skënderbeu. Shënim: Gjergj Kastrioti ishte arbëresh, heroi kombtar i Shqipërisë. Kur ishte jeniçer në Turqi, u dala për aftësinë e tij në artin ushtarak. Sulltani, pasi vuri re talentin dhe trimërinë e tij i dha emrin e Aleksandrit të Madh të Makedonisë "Aleksandër Bei". Në gjuhën turke nuk shqiptohen zanoret në fillim të fjalës, po ashtu grupi bashktingullor "ks" shqiptohet "sk" dhe si rrjedhim emri "Aleksadër Bei" u bë "Skënderbeu". Në vitin 1443 kthehet në

Krujë dhe bëhet prijësi i lavdishëm i arbëreshëve. Për pak kohë çliron nga turqit pjesën më të madhe të Shqipërisë së sotme. Tre sulltanë me radhë e sulmuan me fuqi të madhe ushtarake por vetëm pas vdekjes së tij në vitin 1468 arritën që të ripushtojnë principatën e Skënderbeut.

Arsyet që detyrojnë arbëreshët, si dhe popujt e tjerë, që të marrin rrugën e mërgimit, janë ekonomike-shoqërore-politike. Mërgimi është e vetmja rrugë, kur rëndohet aq shumë jeta e njerëzve në atdheun e tyre.

Brezi i parë i arbëreshëve që u vendosën në tokën greke janë mërgimtarë. Kurse brezi i dytë dhe më tej, fëmijët e tyre që lindin në Greqi, janë grekë. Kur flasim për mërgimin e arbëreshëve në Greqi nuk do të thotë se morën me vete dhe malet, fushat, lumenjtë....Vendi, tokat, malet ku u vendosën janë greke. Me ardhjen e tyre në Greqi marrin me vete gjuhën dhe zakonet e tyre, të cilat i ruajnë për një kohë të gjatë edhe mbasi janë ambjentuar me gjuhën dhe parimet morale të popullit që i mban në gjirin e tij.

Fakti që shumë fshatra të Greqisë të banuara nga arvanitas morën emra arbëreshe siç janë: Vari, Kryekuq, Korbi e tj. nuk do të thotë se nuk janë më fshatra greke.

Po marr si shëmbull qytetin tim të lindjes, Himarën që të mundemi të hedhim më shumë dritë në këtë çështje. Kohë pas kohe himariotët, për arsye të ndryshme, largoheshin nga vendi i tyre. Boshllëku që krijohesh plotësohej nga banorë të tjerë që vinin nga Arbëria. Rreth vitit 1800 Ali Pasha ndoqi nga Himara, Dhërmiu dhe Palasa të gjithë banorët e saj për në Greqi që të sillte osmanë në vendin e tyre. Pas vdekjes të Ali Pashës himariotët u kthyen përsëri në vendin e tyre por jo të gjithë. Në Himarë "nga 300 ane që qenë vetëm 30 u kthenë" (thotë populli) kurse në Dhërmi nga 2500 veta vetëm 700 u kthenë dhe si pasojë paksohej numri i grekëfolësve.

Dikur "Zoti K. Gjika njoftoi kolonelin dhe historianin anglez Lik (M. Leake) si më poshtë:

"Të gjitha fshatrat e Himarës kanë thujtë të njëjtat parime morale dhe zakone të rrepta. Gjuha greke flitet më tepër nga burrat, kurse gratë nuk e dinë mirë greqishten dhe, siç dëgjohen, flasin shqip".

(K. Χατζηαντωνίου «Η Χιμάρα δεύτερη έκδοση, σ. 85).

Të gjitha këto janë "re" që nuk mundin të mbulojnë "Diellin", të pamjaftueshme që të mohojnë origjinën greke të Himarës sepse:

"Njerëzit e parë në krahinën e Himarës u shfaqën 10000 vjet më parë na vendbanimin shpellor të Spilesë. Në lashtësi Himara ishte vendi i Kaonëve, fis i rëndësishëm i Epirit... Emri Himarë vjen drejt-

*përdrejt nga lashtësia, sepse kryeqendra e saj, që prej 3000 vjetësh, si qendër e fortifikuar e deri në ditët e sotme, nuk është braktisur...*¹¹

Vendbanimi i parë që u ndërtua në Himarë i takon periudhës së bronzit në epokën Pelasgjike."¹²

Po aty është ndërtuar më vonë qyteti Omerik, të cilin "e shkatërroi Fivo-s" (për Fivo-n. bëhet fjalë në perëndinë e lashtë greke Apollon) dhe në gërmadhat e tij u ndërtua qyteti historik i Himarës¹³.

Në Himarë flasin greqisht mijëra vjet toponimet: Akroqeravnia, Himara, Andrehora, Megalihora, Gjipea, Panormi, Armiridha, Jaliskari, Pirgos, Paga, Gramata, Kastanea, Paraspori, Kastri, Kasopitra, Apelistra, Gonia, Rahones. Prinosis, Perivoli, Fajeos, Gumenica, Progonati dhe shumë të tjera¹⁴.

Arvanitasit ishin dhe mbetën përgjithmonë të krishterë orthodhoksë (u bën orthodhoksë nga apostulli Pavlo, njëkohësisht me



Një djalosh arvanit. Vepër e Louis Dupré (1819)

grekët - shënimi im). Kaq shumë besonin në fenë e tyre sa që dhe Zotin e konsideronin si njeriun e tyre më të afërt, si babanë e tyre. Besonin se Zoti di vetëm shqip. Kishin dëgjuar nga Bibla citatin «Ἀδάμ ποῦ εἶ;» dhe këtë shprehje e shqiptonin Adham ujë (këtë shprehje e dëgjova nga arvaniti at. A V.) dhe bërtisnin me zë të lartë: ZOTI foli Arvaniteee!

Një pjesë e Arvanitasve që u vendosën në Peloponez formuan çeta luftarake me trima dhe besnikë arvanitas në zona malore, atje ku armiku nuk mundej të ngjitej. Për

¹¹ J. Κοῦς i HIMARA f. 21 μετάφραση στα ελληνικά, π. Π. Γκέζος.

¹² K. Χατζηαντωνίου «Η Χιμάρα δεύτερη έκδοση, σ. 30.

¹³ Στράβωνος Γεωργ. 4 R VII 323 ‘Οπ. Προηγ. 323 από τον K. Χατζηαντωνίου «Η Χιμάρα δεύτερη έκδοση, σ. 85.

¹⁴. “Ένα κλωνάρι από το μεγάλο δένδρο της Χειμάρρας”, ιερέας Π. Γκέζος σ. 119 "Një degë nga pema e madhe e Himarës" me autor at P. Gj. f. 119.

arsye se shpesh nuk guxonin të qëndronin në urdhërat e një udhëheqësi grekofon, i cili mund të ishte pasardhës drejtpërdrejtë i dinastisë së vjetër perandorake, bashkë me grekët e tjerë përbënin një marrëveshje të rëndësishme në luftën kundër Perandorisë Otomane. Këto lidhje të ngushta të çetave greko – arvanitase me grekët luajtën një rol të rëndësishëm në Revolucionin Grek të 1821-shit.

Populli Arvanitas, i cili kurrë nuk u bë “komb”, ndihmoi me kënaqësi popullin grek aq sa mundi dhe së bashku përballuan të mirat e të këqiat në të gjitha furtunat e jetës, qëndroi besnik në fenë e tij ortodokse dhe luajti një rol shumë të rëndësishëm në Revolucionin Grek 1821-shit, sepse e ndjenin veten e tyre si grekë të vërtetë. Kjo ndërjegje e arvanitasit u formua në rrjedhën e ngjarjeve historike shumëvjeçare, të lidhur ngushtë me grekët duke përballuar me sukses dallgët e egra që i goditën në të gjitha krahinat greke ku jetojnë deri sot. Por nuk harruan të folurën e tyre që ndryshon nga gjuha greke. (Po ashtu dhe emrat e tyre, me të cilat u pagëzuan të krishterë, shqiptohen ndryshe nga sa shqiptohen po ato emra në gjuhën greke: Varfi - i varfër. Koka, Kokaveshi, Karzi, Zoto, Gjoka, Gjika, Gjoni, Gjini Koçi. Lekas. Koços, Kiços, Pilos).

Edhe sot e kësaj dite dëgjojmë të thonë: “Κιο γκλιούχα Αρμπερίστε ίστε γκλιούχ τριμερίστε, Εφλιτ ναύαρχοι Μιαούλη, Μπότσαρη εδέ γκιθ Σούλι” d.m.th: “Kjo gjuhë Arbërishte është gjuhë trimrishte, e fliste Miauli, Boçari dhe gjuthë Suli”. Gjuha e Arvanitasve (arvanitika, arvanite, arbërisht) thuhet ndryshe dhe (gljuha e zogjvet ose gljuha e zogut) mbijetoi në Greqi shekuj me radhë deri sot e kësaj dite sepse për arvanitasit gjuha e tyre ishte një thesar i çmuar që e ruanin si sytë e ballit. Një arsye tjetër që nuk e harruan gjuhën e tyre ishte fakti se arvanitasit ishin fanatikë në të gjitha doket dhe zakonet e tyre, si dhe të izoluar hermitikisht në vendbanimet e tyre aq sa u lejonin kushtet e jetesës deri sa ndodhi civilizimi i përgjithshëm i shoqërisë si kudo dhe në Greqi»¹⁵.

¹⁵ ΔΙΑΣΙΜΟΙ ΑΡΒΑΝΙΤΕΣ !!! ΟΙ ΔΡΕΙΣ ΤΟΥ ΝΕΩΤΕΡΟΥ ΕΛΛΗΝΙΣΜΟΥ. Ειδικό Αφιέρωμα Του εκδότη του www.Apodimos.com Ξενοφώντα Φαφούτη. (Përktheu në shqip at P. Gjezo).

“Arvanitasit janë të krishterë orthodoxë dhe flasin dy gjuhë (arvanitasen dhe greqishten). Gjuha e tyre arvanitase ka të njëjtën prejardhje me gjuhën e sotme shqipe. Gjuha arvanitase me kalimin e kohës harrohet për dy arsye: e para nga lëvizja e popullsisë prej fshatrave, ku banonin arvanitasit, drejt qytetit duke rënë kështu në kontakt me greqishten dhe e dyta nga rrethi politik, kulturor dhe shoqëror grek”¹⁶.(Από ΛΑΡΥΜΝΑ Τρίτη, 10 Απριλίου 2012 "λίγα λόγια για τους Αρβανίτες". Περktheu në shqip at P. Gjezo)

Gjuha arvanitase është dëgjuar shumë herë dhe brenda në parlamentin grek. “Historiani grek Γιάννης Βλαχογιάννης (Janis Vlahojanis) midis të tjerash sjell një shembull nga një mbledhje në Parlamentin e parë grek të 1821-shit. Në diskutim e sipër nga deputetët që ndodheshin në Parlament, një deputet u detyrua të ndërhyjë dhe të flasë në gjuhën arvanitase për të vendosur qetësinë sepse po zhvillohej një bisedë në një situatë shumë të acaruar”. (përktheu në shqip at P. Gjezo).

Në shekullin e 20të, shumë arvanitas morën pjesë në luftën Makedhonase (1903), ku dhe ra në fushën e betejës Vangjel Koropulis nga Mandra e Atikisë.



Pamje nga vrasja e kryetarit të çetës Vangjel Koropulis, bashkluftëtar i Pavlo Melas, në Makedhoninë Perëndimore, duke luftuar kundër turqve.

¹⁶ Από ΛΑΡΥΜΝΑ Τρίτη, 10 Απριλίου 2012 "λίγα λόγια για τους Αρβανίτες". (Περktheu në shqip at P. Gjezo)

Petro Furiqi
1878 – 1936



Folklorist dhe filolog, drejtor i arshivës folklorike të Akademisë së Athinës dhe një nga bashkëpunëtorët kryesorë të hartimit të Fjalorit Historik të Gjuhës Greke. Muzeu i Artit Popullor dhe i Historisë në bashkinë e Salaminës përmban emrin e Petro Furiqit.:

“...Disa të ashtuquajtur aristokratë, që mendojnë se kanë zbritur nga qielli dhe harrojnë origjinën e tyre, mohojnë çdo ngjarje të vërtetë të historisë, përpiqen herë me ironi, herë me ofendime të kryejnë gjoja detyrimin

që kanë ndaj greko-arvanitasve, d. m. th. të arvanitasve të lashtë, të cilët nga Suli deri në Mesolongji dhe nga Janina në Idra e në Speces...kanë derdhur gjakun lumë për lirinë e përbashkët në Greqi.

Janë krenarë mësuesi i shkollës dhe profesori i Universitetit, kur u mësojnë nxënësve të tyre historinë e Skënderbeut, heroizmin e Marko Boçarit, sakrificat e Kunturiotit dhe të Meksit, zgjuarsinë dhe trimërinë e Mjaulit dhe akoma më shumë krenohen për betejën që bëri luftëanija Eli, që drejtohej po ashtu nga një tjetër Kunduriot dhe nevrkoset ai mësues që disa “aristokratë” nuk e vlerësojnë aq sa u takon heroizmin dhe bamirësinë e greko-arvanitasëve. Pse nuk u treguan dhe ata “aristokratë” kaq të fortë sa heronjtë e luftës, gjeneralët dhe admiralët greko- arvanitasit? E vërteta është e hidhur por ajo i ndihmon shumë gjithë ata që e njohin të vërtetën. Historia është ajo që gjithmonë na tregon me saktësi se cila është e vërteta. Lum si ai që di të vlerësojë dhe të përfitojë nga e vërteta. Duke qenë i sigurtë se nuk bëj ndonjë gabim etnik, kur shpreh me gjakftohtësi, me sinqeritet dhe duke qenë i paanshëm, një të vërtetë historike, do të

vazhdoj të bëj të njohur tek lexuesi shpirtin dhe mendjen e greko-arvanititasve, i bindur plotsisht se vë në dukje pjesë nga jeta dhe historia greke të fshehura brenda në shpirtin, në mendjen dhe në doket e bashkpatriotëve të mi arvanitas”¹⁷.

Disa arvanitas u bënë myslimanë.

" Perandoria Otomane, siç veproi në të gjitha vendet e tjera, arriti që edhe në Greqi të sjellë fenë e saj islame. Shumë të krishterë, për të marrë ofiqe, rroga dhe pasuri u bënë myslimanë. Kështu ndodhi dhe në krahinën Margaritiu Thesprotias, një pjesë e të cilës më vonë u quajt "Çamëria" (Τσαμουριά).

Një tjetër arsye që u bënë myslimanë disa të krishterë ishte dhe komunikimi i gabuar i përfaqësuesve të fesë kristiane me besimtarët e tyre. Po japim një shembull. Në librin me dy vëllime të z. Αλεξ. Χ. Μαρμόπουλος "ΗΠΕΙΡΟΣ", vëllimi i parë faqe 18 dhe në vazhdim...lexojmë: “Në një fshat, nga mungesa e vazhdueshme e ushqimeve, banorët ishin dobësuar kaq shumë sa rrezikonin të vdisnin nga uria. Kur filloi të pjellë bagëtia, u gëzuan se do të mund të pinin pak qumësht, të hanin pak djathë dhe të therrnin ndonjë sheleg që të hanin pak mish. Në atë kohë ishte kreshma e pashkës dhe ndalohej kategorikisht që të hanin ato ushqime të domosdoshme për shëndetin e tyre. Shkuan te Dhespoti dhe iu lutën që t' i lejonte të hanin nga ushqimet e ndaluara në atë periudhë, se rrezikonte jeta e njerëzve. Dhespoti jo vetëm që nuk i lejoi të hanin ushqimet e ndaluara për atë periudhë ,por dhe i kërcënoi se kështu do të shkonin në Ferr, ku do të vuanin në shekuj. Ata banorë të krishterë të pakënaqur nga Dhespoti shkuan në një fshat fqinj, ku banonin myslimanë dhe ju lutën Hoxhës t' i ndimonte që të mos vdisnin nga uria. Hoxha së pari kërkoi të ndërronin fenë e tyre, të bëheshin myslimanë pastaj mund të hanin nga të gjitha ato ushqime të ndaluara. U premtoi se ai do të ndërmjetësonte te Zoti, që t' u falte mëkatin. Kështu do të zgjidhnin problemin e shëndetit pa humbur Parajsën. Kësisoi u islamizuan një pjesë e konsiderueshme e asaj krahine".

¹⁷ Përkthen në shqip at P. Gjjezo.

Po ashtu dhe z. Spiros Muslimi i Gjergjit dhe Elenës në librin e tij "ΙΣΤΟΡΙΚΟΙ ΠΕΡΙΠΛΑΤΟΙ ΑΝΑ ΘΕΣΣΑΛΙΑ" (Udhëtime historike në Thesprotia) bën fjalë për islamismen me forcë që bëhet në Thesprotia (faqe 34-27 të librit). Për këtë çështje bën fjalë mësuesi me origjinë nga Seljani në librin e tij "Çamët- shqiptarë të krahinës Paramithja" në faqen 41¹⁸.

Vangjel Liapi në veprën e tij "Σεξουαλική Λαογραφία" "Folklori seksual arvanitasve", midis të tjerave, thekson:

"Arvanitasit e Greqisë ishin kristianë orthodhoksë, me dy gjuhë: shqipen dhe greqishten dhe me ndërgjegjen e kombit grek që e fituan qindra vjet para sundimit turk në Greqi. Herë pas here largoheshin nga vendbanimi i tyre, sidomos kur ndodheshin në vende malore dhe mundoheshin të gjenin kushte më të mira jetese në gjithë Greqinë. Janë ata që luftuan me trimëri në Revolucionin Grek të vitit 1821-shit. Pas formimit të shtetit të lirë grek, arvanitasit prisnin të fitonin dhe ata disa të drejta nga lufta me sakrifica që bën për të ndjekur sundimin turk nga Greqia. Megjithëse pjesa më e madhe e arvanitasëve ishin katundarë, shumë prej tyre arritën të kryejnë detyra të rëndësishme në Qeverinë Greke deri në Kryetarë Qeverie". F. 17

"Historia e këtij populli (arvanitasve) flet qartë për jetën e tyre shumë të vështirë në Greqi. Erdhën në Greqi me shumë merak, me tjetër kombësi dhe me frikën e nënshtimit në punë shumë të rënda nga pronarët që do t' i punësonin. Para së gjithash u lidhën me besë midis tyre. Fakti që ishin kristianë orthodhoksë ndihmoi shumë për vendosjen e tyre në Greqi.

Varfëria dhe analfabetismi i dallonte nga të tjerët dhe u mbyllën në vetvete. Ajo gjendje solli izolim dhe marrëdhënie njerëzore të ftohta me vendësit duke mbetur në shoqëri të izoluar nga të tjerët deri në fund të shekullit 19-të. F.120

Përshkrimi i të kaluarës, edhe pse është treguar me një nostalgji të natyreshme dhe me fantazi të madhe, nuk na frymëzon në asnjë moment që të dëshirojmë të jetojmë edhe një herë ato vite të kaluara. Ajo që mbetet të bëjmë është të përshkruajmë me saktësi të kaluarën, sepse ajo është rruga që ndoqëm për të arritur këtu që jemi sot"¹⁹.

¹⁸ Nga libri i z. Fotios M. Athanasios " Gramatika e gjuhës shqipe" faqe 49,50,51. (Përkthen në shqip at P. Gjezo).

¹⁹ Βαγγέλης Λιάπης "Σεξουαλική Λαογραφία" f.17, 120,141. (Përktheu në shqip at P. Gjezo).

Gjuha arbëreshe

«Κιογ κλιούχα Αρμπερίστε ίστε γκλιούχ τριμερίστε. Ε φλιτ ναυάρχοι Μιαούλη, Μπότσαρη εδέ γκιθ Σούλι..». (Ξενοφώντα Φαφούτη).

« FJALORI ARBËRESH 2015».

Konstantin Çopani

Dr. i Historisë dhe Filozofisë të feve të ndryshme.



Kur isha 14 vjeç, në agimin e parë të jetës sime kisha lexuar Zhyl Vern në disa libra të lidhur, të bukur e të vegjël, te botimeve “Asteros”, që ende i ruaj në bibliotekën time. Edhe është e vërtetë që ato përkthime të jashtëzakonshme të Zhan Pol Menestrel dhe të tjerëve më ndihmuan jashtë mase të mësoj shumë mirë gjuhën greke. Në këtë moshë nisa të kuptoj që në vendin ku unë jetoja dhe rritesha, ishin dy gjuhë, një gjuhë po tërhiqej dhe një gjuhë që po fitonte tokë. Gjyshërit dhe me tepër gjyshet – në

përgjithësi njerëz që me plot kuptimin e fjalës, vinin nga një tjetër botë dhe një tjetër kohë – flisnin pothuajse ekskluzivisht vetëm Arbërisht, një gjuhë që të kulturoarit e zonës, por edhe brezi i prindërve tanë e kishin hedhur poshtë si “e ndyrë dhe e pavlerë!”.

Ne u rritëm duke dëgjuar dhe duke kuptuar atë gjuhë të çuditshme si njohës pasiv, edhe ca herë duke mësuar në mënyrë ataviste ca fjalë apo frazë të saj. Atëherë ne ishim asnjëanës përballë gjuhës por nuk

guxonim të flisnim fjalë a shprehje, që të mos provokonim qeshjen ose ironinë e më të mëdhenjve.

Si shkonin vitet, nisa të shikoj se gjuha dëgjohej gjithnjë e më pak, edhe gjithnjë e më rrallë të shanin akoma në Arbërisht. Brezi i gjyshërve iku shpejt dhe kushdo që ikte merrte me vete edhe një pjesëz të gjuhës. Një ditë në shkollë, kujtova një histori për një stërgjysh timin italian të cilin e kisha dëgjuar mjaft here duke folur vetëm në Arbërisht. Sidoqoftë, atëherë u binda se edhe pse e mbaja mend historinë, nuk mund ta shprehja në gjuhën të cilën e kisha dëgjuar aq shumë herë. Por ‘refrenin’ e historisë ma thoshin, vite më parë djemtë e tjerë në oborrin e shkollës fillore për të më ngacmuar. Në gjimnaz asnjë nga nxënësit e tjerë nuk e kujtonte për të ma thënë në arbërisht, edhe pse të gjithë e mbanin mend historinë.

Duke ardhur ne shtëpi, si melankolik dhe kokëfortë bashkë, mora nje stilolaps dhe një fletor dhe fillova të shkruanja çfarë mbaja mend nga kjo gjuhë, fjale, proverba, këngë, tekste, poezi, histori. Shumë herë pyesja babain tim, i cili e dinte gjuhën por si pasojë e atyre që besonte brezi i tij, refuzonte ta fliste. Edhe ai, dalëngadalë, më thoshte atë që unë i kërkoja po çdo herë nuk harronte të thoshte: “Çë i do këto nani, mosnjeri nëk e flet”. Në fillim mundohesha ti them që nuk më interesonte çfarë bënin të tjerët por me kalimin e kohës ndalova të përgjigjesha duke u trazuar në monologe paralele me të, pasi gjithnjë ai i përgjigjej pyetjeve të mia.

Deri sa një ditë, ai me dëshirën e tij deshi të më mësojë që të numëroj saktë në arbërisht. Pas aritmetikës vijonin histori të tëra dhe më pas këngët. Si përrua i ndaluar nga heshtja, tashmë fjalët, frazat etj etj filluan të derdhen në fletorin tim shkollor. Por si mund të vësh një traditë shekullore të gjallë deri në kohën e Mesluftës në faqet e nje fletori të vetëm? Ashtu, sa herë një fletore mbushej e pasonte tjetra dhe tjetra dhe tjetra dhe bashkë me fletoret mbushej edhe memorja ime me pamje dhe zëra të një bote tjetër - histori shekullore në tokën e Atikës, të dëftuara dhe të kënduara të gjitha në “gluhën e zogut”, siç e quanin paraardhësit tanë gjuhën tonë para se ajo të bënte viktimë e rrafshimit të çdo elementi identiteti në altarin absolut dhe asimilues që rrafshoi pamëshirshëm dhe brutalisht çdo identitet. Edhe këto faqe janë shkruar jo për qëllim studimor por që të

mos humbasë kujtesa e përbashkët e gjuhës sonë.

Me shumë të drejtë mund të pyesë dikush: Sot që te gjithë duan të harrojnë, jo vetëm gjuhën (sepse ajo është e harruar bashkë me shumë emra arbërorë të vendeve dhe katundeve tanë), por edhe sepse ajo dikur flitej në këtë vend. Çfarë është ajo që më beri t'i hyj këtij mundi? Mund të përgjigjem duke thënë se bëra një detyrë të shenjtë ndaj brezave që shkuan por edhe ndaj hijeve të gjyshërve të mi, që nga thellësitë e viteve që kane kaluar, nga brenda zërit të babait tim, më thanë: “gjegje djalëthi im që të thonë edhe mos harro”. Ky libër është përgjigja ime praktike: “nëk e harrova...”

Pelazgja

«Pelazgja» është një fjali (pe+ las (lamps-gr. ndriçim)+gji (γι – γη ose δη - δέα-δα)+a

Në kohën e lashtë, siç e dimë, fjalitë shkruheshin me fjalë të ngjitura njera me tjetrën si një fjalë e vetme. Me gjithë vështirësinë që hasim për të lexuar fjalinë që shpreh kjo fjalë, do të mundohemi t' i afrohem kuptimit të saj. Në fjalinë e mësipërme shohim fjalën (las - lamps-gr. Ndriçim). Në fjalën “las - lamps-gr” diftongu “la” zakonisht na jep:

1. “al” siç duket në fjalën “Al – bania” dhe në shumë fjalë të tjera në gjuhët asiatike dhe evropjane: Latinisht Albis, Albia, qytetin Albano Laziale, mal Alpet, Lago Albano, në Kaukaz (Gjeorgia) emrii një krahine Albania... Të gjitha këto fjalë shprehin ndriçim. 2. «,ηλ,» ήλιος (gr. Dielli), 3. υλλ'Υλλε, Ylli, Yllëz dhe 4. «ελλ» (έλληνας,) grek, ...të cilat shprehin po ashtu ndriçim.

Në fjalinë “Pelazgja” kemi parafjalën “pe”, që në italisht është “per” dhe në shqip “për”. Kemi dhe emrin “λασ” “ndriçim dhe fjalën “gji” «γι – γη» ose δη ose δέα-δα me kuptimin “dhe – u”

Si përfundim mendojmë që fjalia “Pelazgja” do të thotë “Vend i ndritshëm”.

Disa shembuj që na ndihmojnë të kuptojmë më mirë për sa folëm më lartë:

1. "Ylli". Yllëz, Ylle,

2. "Qielli". Këtu kemi një fjali: Qi, ky, ai, aty+e + ll - i (ndriçimi) = Aty është drita. "ci - + lo = cielo (në italisht – qielli).

3. "Dielli": Δί - ας (gr. Zoti) ose Di - o (it. Zot) ose Perën – di - a (1)(per – për - n + di ,(Zot) +e + ll - i = Perëndia Ylli që ndriçon gjithandej.

(1) Në çdo krahinë, ku banojnë Arvanitas, të kalosh do të dëgjosh shpesh dy fjalë: Dias (Perëndia) dhe Zeus si dhe ziarri, ziej, Zoti, të cilat shprehin dy fenomene të natyrëshme të planetit TOKË: Drita dhe Ngrohtsia²⁰.

(Φ. Μ. Αθανασίου Γραμματική Αρβανίτικης Γλώσσας σ. 46 - Grammatika e Gjuhës Arbëreshe f, 46)

4. "Ηλι - ος" (në gr. dielli) "Dielli"

5. "Σελήνη", λή (ndriçimi) = φέγγει ose λαμπιρίζει = φεγκαρι = Hëna (sigurisht është një fjali e përngjitur).

6. "Ελλη - ν", «Ελλάδα».

Bashkëtingëllorja "L", është shprehja e ndriçimit me kuptimin e Dritës në përgjithësi dhe në veçanti Krijuesin e Dritës.

Është tingulli i fjalëve shqipe "Ylli", "Dielli" dhe «Qielli» si dhe të fjalëve greke: «Ἥλιος» "Σελήνη", "Ελλην", «Ελλάδα». Si rrjedhim mund të themi se kanë të drejtë gjithë ata studiues që thonë se gjuha shqipe dhe gjuha greke janë dy bija të pelazgjishtes.

²⁰ Φ. Μ. Αθανασίου Γραμματική Αρβανίτικης Γλώσσας σ. 46 - Grammatika e Gjuhës Arbëreshe f, 46

Disa mendime për emrin«Albania».

Al – ban ia, për bashëtingëlloren«l» bëmë fjalë mësipër, kurse«ban» ose«bun» (fjala më e lashtë e fjalës "ban") na tregon banim - i. Fjalën «bun» e gjejmë toponim "Bun - a" në Pilur të Himarës, ku ekzistojnë ende dhe sot rrënoja shtëpish të vjetra, është dhe emri i fshatit të Himarës "Vun - o" (bun - o) po ashtu në qëndër të Spiles - Himarë kemi një toponim Vun - ja – i - (bun - jai), rrjedh nga fjala "bun" (banim), një toponim "Vun - ena" "Βούνεα" në afërsi të qytetit Larisa në Greqi. (Ky toponim si fjalë nuk spjegohet me fjalorin greqisht) Si përfundim jam i mendimit se fjala "Albania", ka kuptimin "banim i ndritshëm" (vendbanimi që ndriçohet nga drita e madhe që vjen nga lart).

